



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Legjislatura II

Nr. ...

23.08.2007, Prishtinë

PROCESVERBAL

i mbledhjes së Komisionit për Buxhet dhe Financa

Mbledhja është mbajtur më 23.08.2007 në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës, salla N-225 dhe filloi në orën 11,00.

Nga shërbimi i Sekretariatit të Kuvendit në mbledhje ishin të pranishëm:

Natasha Tishma – Prica, bashkëpunëtoresh profesionale e Komisionit,

Arta Hajra – asistente ligjore,

Monitoruesit e OSBE dhe të NDI-së.

Mbledhjen e kryesoi Naser Osmani, kryetar i Komisionit.

Pasi që konstatoi se në mbledhje nuk janë të pranishëm Gani Koci, Demir Lima, Rifat Krasniq, Ali Sadriu dhe Nazim Jashari, anëtarë, kryetari e hapi mbledhjen dhe propozoi këtë:

Rend dite

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
3. Miratimi i Raportit nga tryeza e rumbullakët të agjencive të pavarura e mbajtur me 16 dhe 17 korrik 2007,
4. Shqyrtimi i Raportit të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit për vitin 2006,
5. Shqyrtimi i Projektligjit për bujqësinë organike dhe i Raportit të Komisionit Funkcional – Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente,
6. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 2004/1 për komunikacionin rrugor dhe i Raportit të Komisionit funksional, - Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Transport dhe Telekomunikacion, me amendamente,
7. Shqyrtimi i Projektligjit për vendqëndrimin dhe vendbanimin dhe i Raportit të komisionit funksional – Komisioni për Siguri, me amendamente,

8. Shqyrtimi i Projektligjit për ndërmarrjet afariste dhe i Raportit të komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Transport dhe Telekomunikacion, me amendamente,
 9. Shqyrtimi i Projektligjit për statusin civil dhe i Raportit të komisionit funksional – Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, me amendamente,
 10. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 2004/46 për regjistrin e statusit civil dhe i Raportit të komisionit funksional – Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, me amendamente.
 11. Të ndryshme.
1. Kryetari i Komisionit propozoi që rendi i ditës, para se të miratohet, të plotësohet dhe që në kuadër të pikës “Të ndryshme” të shqyrtohen tri çështje dhe një informatë.
 - 11.1. Shqyrtimi i kërkesës së Ministrisë së Financave që Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural t’i bartet shuma e mjeteve prej 300.000€ nga kategoria e investimeve kapitale në kategorinë e subvencioneve.
 - 11.2. Shqyrtimi i kërkesës së Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave që Ministrisë së Energjisë dhe Minierave t’i bartet shuma e mjeteve prej 1.000.000€ nga kategoria e investimeve kapitale për Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit në kategorinë e investimeve kapitale për Programin e transmisionit KOST.
 - 11.3. Shqyrtimi i kërkesës së GP – LDD për zbatimin e vendimit të Kryesisë së Kuvendit për dhënien e mjeteve financiare partive politike dhe grupeve parlamentare të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës.
 - 11.4. Informatë lidhur me propozimin e Komisionit për Buxhet Kryesisë së Kuvendit me rekomandimin për bartje buxhetore Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për vitin 2007 të datës 31.07.2007.

Kryetari i Komisionit, pasi konstatoi se rendi i ditës, i plotësuar, u miratua, hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua me vërejtjet e nënkryetares së dytë, Safete Hadërgjonaj, lidhur me pikën “Të ndryshme” dhe e ngarkoi stafin e Sekretariatit që t’i inkorporojë vërejtjet e dhëna.

Kryetari e hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës.

3. Miratimi i Raportit nga tryeza e rrumbullakët të agjencive të pavarura e mbajtur me 16 dhe 17 korrik 2007

Kryetari konstatoi se raporti u miratua dhe i njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me efektet pozitive të mbajtjes së tryezës së rrumbullakët që e ka organizuar ky komision së bashku me OSBE-në, në të cilën ka marrë pjesë ushtruesi i detyrës së ambasadorit të OSBE-së për shkak të shqyrtimit të përgjithshëm të buxhetit të agjencive të pavarura. Përfundimet, rekomandimet dhe qëndrimet e përgjithshme të miratuara në këtë tryezë të rrumbullakët do t’i dërgohen nëpërmjet Kryesisë së Kuvendit Qeverisë me rekomandime konkrete. Gjithashtu Komisioni ka të drejtë të kërkojë

këshilltar nga lëmi i financave i cili do të angazhohet rreth punëve të mëtutjeshme në Komision, e ky këshilltar është ish ministri i Financave i Estonisë. Lidhur me veçoritë e kësaj mbledhjeje dhe të temave për të cilat u diskutua, Komisioni mund të informohet nga raporti i dërguar.

Kryetari e hapi diskutimin për pikën e 4-të të rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i Raportit të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit për vitin 2006

Kryetari: Neni 5 paragrafi 7 i Ligjit për telekomunikacionin e obligon Komisionin ta shqyrtojë raportin vjetor të ART i cili hartohet më së voni 6 muaj nga përfundimi i vitit fiskal dhe i cili duhet të përmbajë treguesit financiarë për vitin e ardhshëm. Sot e kemi për shqyrtim këtë raport dhe e thërras përfaqësuesin e ART –së që në pika të shkurtra ta paraqesë para Komisionit, ndërsa anëtarët e Komisionit t'i japin mendimet.

Petrit Dërguti – zyrtar i Zyrës Ligjore të ART :

Pikat kryesore të paraqitura në raport janë:

- Objektivat dhe revizioni,
- Zbatimi i legjislacionit,
- Formimi i Komisionit të Auditimit,
- Raportimi financiar me pasqyrat financiare,
- Menaxhimi i të hyrave dhe i të dalave financiare, dhe
- Funksionimi i Bordit.

Raporti është hartuar me qëllim të raportimit Kuvendit për aktivitetin e ART-së në pajtim me kërkesat financiare dhe raportuese të përcaktuara me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit të sektorit publik, si dhe në pajtim me Kornizën e miratuar të MEF-it, Udhëzimit Administrativ 2006/14.

ART duhet t'i kryejë obligimet dhe të drejtat e saj në pajtim me Ligjin për Telekomunikacionin. Ai monitoron lëmin e telekomunikacionit në mbarë territorin e Kosovës, kështu që të gjitha kompanitë që operojnë në territorin e Kosovës duhet t'i nënshtrohen këtij ligji.

Funksionimi në pajtim me ligjin nuk ekziston për shkak të pengesave objektive të cilat pamundësojnë kontrollin në tërë territorin e Kosovës. Për këtë shkak ekzistojnë pengesa në realizimin e të ardhurave vetjake në dy drejtime. E para, PTK-ja si kompani nuk është e gatshme ta paguajë shumën e kontraktuar për shkak se ART-ja nuk ka qenë në gjendje ta mbikëqyrë gjendjen në mbarë territorin e Kosovës. E dyta, kanë ekzistuar kompani ilegale që kanë operuar në territorin e Kosovës e të cilat nuk kanë paguar as një taksë për veprimtarinë e tyre, d.m.th kanë punuar ilegalisht.

Gjithashtu, dua të theksoj se ART-ja së bashku me komisarën e përkohshëm për media duhet ta koordinojë aktivitetin e transmetuesve, që deri më sot nuk është realizuar.

Në të gjitha pengesat të cilat na kanë përcjellë nuk kanë qenë të përfshira organet e policisë dhe inspektorët në terren, kështu që ishte e pamundur të bëhet pagimi i frekuencave.

Kuadri ka nevojë për aftësim të përhershëm në lëmin e telekomunikacionit i cili do të jetë në gjendje t'i analizojë pasqyrat financiare të ofruesve të shërbimeve të cilat i mbikëqyr ART-ja, dhe duhet të emërohen inspektorët e përhershëm për verifikimin e kushteve ligjore të licencave.

Sa i përket aspektit financiar kjo kompani punon në pajtim me ligjin, kështu që asnjë transaksion nuk mund të kryhet pa nënshkrimin e kryetarit të bordit.

Buxhetin e ART-së e cakton Kuvendi i Kosovës, përderisa financimi bëhet nga të ardhurat vetjake. Gjatë vitit 2006 nuk është bërë asnjë ndryshim i buxhetit. Buxheti i gjithmbarshëm është 794.254.000 € i paraqitur sipas kategorive. Sektori për raportim ka përgatitur pasqyrën financiare të paraqitur në mënyrë tabelore në të cilën mund të shihet gjendja e parave të gatshme, e të hyrave dhe e të dalave, shpërndarja e buxhetit, ndryshimi i buxhetit, i të ardhurave të pa arkëtuara dhe i faturave të pa arkëtuara.

Mendimet, sugjerimet dhe propozimet e Komisionit

Nënkryetarja e dytë e Komisionit, Safete Hadergjona: Dëshiroj t'i paraqes disa mendime lidhur me raportin të cilin sot po e shqyrtojmë.

E para, raporti është hartuar me kohë, por ne po e shqyrtojmë paksa me vonesë. Mendoj se së bashku me raportin e auditorit është dashur ta kemi edhe një raport detaj të ART-së lidhur me veprimtarinë financiare, sepse në material janë paraqitur shifrat e rumbullakuara e jo treguesit detaj financiarë dhe kjo është njëra prej mangësive të raportit. Pyetjet e mia janë këto:

- Pse janë shfaqur problemet ndërmjet ART-së dhe PTK-së?
- Cilat janë shkaqet e ndarjes së ART-së dhe Komisionit për Media (në këtë kuptim ART-ja nuk e ka kryer punën që ka qenë e detyruar ta kryejë, por vetëm ka bërë fushatë për mënjanimin e operatorëve ilegalë).
- Mbledhjet e Bordit nuk kanë qenë të rregullta siç është paraparë me nenin 6 të Ligjit për telekomunikacionit, sepse mungojnë anëtarët e duhur të Bordit dhe kjo ka për pasojë mbajtjen e mbledhjeve jo të rregullta dhe miratimin e vendimeve me vetëm 2/3 e anëtarëve të emëruar.
- Kuvendi asnjëherë nuk ka marr informacione të nevojshme lidhur me atë se për ç'arsye nuk janë arkëtuar të hyrat, do të thotë nuk ka pasqyrë të qartë për të hyrat e arkëtuara nga grumbullimi i tatimeve të ndryshme, që është mangësi shumë e madhe;
- Janë evidente shkeljet e procedurave përkitazi me prokurimin publik dhe është dhënë mundësia për manipulime, kështu që nuk dihet cili është ofertuesi më i favorshëm;
- Tabela 3, Pasqyra e përmbartimit të buxhetit, paraqet shumën e përgjithshme prej 794,254.80 € ndërsa alokimi i buxhetit 981, 628.66 € është i paqartë, prandaj është e nevojshme të dihet pse u bë kjo diferencë;

Lutfi Zharku: Në parim mendoj se punën e ART-së është dashur që ta shqyrtojmë në bazë të raportit të tyre. Në raport është dashur të përfshihen edhe çështje të tjera që nuk qëndrojnë këtu. Raporti i auditorit nuk më pëlqen, meqë edhe auditori është lëshuar në disa gjëra që nuk janë në kompetencë të tij. Auditori i sugjeron Kuvendit se çka duhet të ndërmerret Kuvendi, që nuk është në rregull. P. sh, konstaton se ekziston keqpërdorimi i automjeteve. Sugjeroj që për këtë çështje për shkak të mungesës së Rregullores për shfrytëzimin e automjeteve të hartohet një rregullore e brendshme e cila më për së afërmi do t'i rregullonte rregullat dhe do të sillte konsumin në kufij normalë.

Besa Gaxherri: Pajtohem me vërejtjet e kolegëve të mi dhe dua të shtoj këtu para komisionit, dhe natyrisht edhe në Kuvend për obligimet e autoriteteve ndaj çdo institucioni, me këtë rast edhe për ART-në i cili është problem në vete në nivel institucionesh. Duhet të jemi vetëkritik në mënyrë që të luajmë rol konstruktiv dhe të jemi më transparentë. P.sh. thuhet se UNMIK-u e kontrollon brezin e frekuencave. Ky është një problem të cilin dua ta theksoj. Dikujt kjo i konvenon, kurse qytetarëve të Kosovës kjo u kushton. Është e domosdoshme që në këtë fushë të vendoset një koordinim më i mirë ndërmjet Kuvendit, ART-së dhe UNMIK-ut.

Kryetari: Fare qartë mund të shihet se raporti i ART-së ka mangësitë e veta, meqë nuk përmban elemente standarde gjithëpërfshirëse si raport që duhet të nënkuptojë pjesën punuese dhe financiare dhe të mos përmbajë raportin origjinal të auditorit për ART-në. Gjithashtu, mund të konstatohet se raporti nuk përmban përshkrimin e aktiviteteve të çdo anëtari të Bordit të ART-së. Për këtë arsye propozoj që ART deri në javën e ardhshme (për shtatë ditë) të dërgojë raportin e korrigjuar me pjesën shtesë financiare, në të cilin do të inkorporohen mangësitë e theksuara dhe të paraqiten në mbledhjen e Komisionit.

Pas këtyre mendimeve, sugjerimeve dhe propozimeve të paraqitura, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

Obligohen përfaqësuesit e ART-së që gjatë javës së ardhshme ta dërgojnë Raportin e korrigjuar për punën e ART-së së bashku me pasqyrën financiare, raportin origjinal të auditorit për ART-në dhe raportin për çdo anëtarë të Bordit të ART-së.

Kryetari e hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i Projektligjit për bujqësinë organike dhe të Raportit të komisionit funksional-Komisionit të Bujqësisë, Pylltarisë, Zhvillimit Rural, Ambientit Jetësor dhe të Planifikimit Hapësinor me amendamentet e propozuara

Mazllom Kumnova: Propozoj ndryshimin e lartësisë së gjobës me të holla dhe riformulimin e tekstit të nenit 15, si në vijim: të riformulohet paragrafi i fundit i nenit 15 të Projektligjit:

15.9 “ për veprimet e parapara në këtë nen dënohet për kundërvajtje edhe personi përgjegjës dhe personi juridik me gjobitje me të holla në shumë prej 1.000 – 3.000 €

Duke pasur parasysh se nuk kishte propozime të tjera, kryetari i Komisionit konstatoi se propozimi i Mazllom Kumnovës për ndryshim miratohet si amendament i komisionit , prandaj Komisioni nxjerr këtë:

P e r f u n d i m

1. Komisioni i ka shqyrtuar projektligjin dhe raportin e Komisionit funksional – Komisionit të Bujqësisë, Pylltarisë, Zhvillimit Rural, Planifikimit Hapësinor dhe të Ambientit Jetësor me amendamente, duke konstatuar se nuk përmban implikime buxhetore, prandaj i propozon Kuvendit që të njëjtin në procedurë të mëtejme ta shqyrtojë dhe miratojë.

2. Komisioni i rekomandon Kuvendit propozimin për këtë ndryshim:

Amendamenti 1.

Të bëhet numërimi dhe riformulimi i paragrafit të fundit të nenit 15 të Projektligjit dhe të jetë: 15.9 “për veprimet e parapara me këtë nen dënohet për kundërvajtje edhe personi përgjegjës dhe personi juridik me gjobitje në shumë prej 1.000– 3.000 €”.

Kryetari e hapi shqyrtimin për pikën e 6 të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i projektligjit për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 2004/1 për komunikacionin rrugor dhe raportin e Komisionit funksional – Komisionit të Bujqësisë, Tregtisë, Industrisë, Transportit dhe Telekomunikacionit me amendamente.

Duke pasur parasysh se nuk kishte vërejtje lidhur me Projektligjin dhe me raportin e Komisionit funksional me amendamentet e propozuara, Komisioni nxjerr këtë:

P ë r f u n d i m

Miratohen dispozitat e Projektligjit për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 2004/1 për komunikacionin rrugor dhe raporti i Komisionit funksional – Komisionit të Bujqësisë, Tregtisë, Industrisë, Transportit dhe Telekomunikacionit me amendamente, duke konstatuar se nuk përmban implikime buxhetore, prandaj i rekomandon Kuvendit që këtë në procedurë të mëtejme ta shqyrtojë dhe ta miratojë.

Kryetari e hapi shqyrtimin lidhur me pikën e 7- të të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i Projektligjit për vendbanimin dhe vendqëndrimin dhe raporti i Komisionit funksional – Komisioni i sigurisë me amendamentet.

Duke pasur parasysh se nuk kishte vërejtje lidhur me Projektligjin dhe raportin e Komisionit funksional me amendamentet e propozuara, Komisioni nxjerr këtë:

P ë r f u n d i m

Miratohen dispozitat e Projektligjit për vendbanim dhe vendqëndrim dhe raporti i Komisionit funksional – Komisionit të sigurisë me amendamente, duke konstatuar se ky nuk përmban implikime buxhetore, prandaj i rekomandon Kuvendit që në procedurë të mëtejme ta shqyrtojë dhe miratojë.

Kryetari hapi shqyrtimin për pikën e 8-të të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i projektligjit për shoqëritë afariste dhe raporti i Komisionit funksional – Komisionit të Bujqësisë, Tregtisë, Industrisë, Transportit dhe Telekomunikacionit me, amendamente

Duke pasur parasysh se nuk kishte vërejtje lidhur me Projektligjin dhe as me raportin e Komisionit funksional me amendamentet e propozuara, Komisioni nxjerr këtë:

P ë r f u n d i m

Miratohen dispozitat e Projektligjit për shoqëritë afariste dhe raporti i Komisionit funksional – Komisionit të Bujqësisë, Tregtisë, Industrisë, Transportit dhe Telekomunikacionit me amendamentet, duke konstatuar se nuk përmban implikime buxhetore, prandaj i propozon Kuvendit që në procedurë të mëtejme ta shqyrtojë dhe miratojë.

Kryetari hapi shqyrtimin lidhur me pikën e nëntë të rendit të ditës.

9. Shqyrtimi i Projektligjit për statusin civil dhe të raportit të Komisionit funksional – Komisionit të shërbimeve publike, administratës lokale dhe media me amendamente.

Duke pasur parasysh se nuk kishte vërejtje lidhur me këtë Projektligj dhe as me raportin e Komisionit funksional me amendamentet e propozuara, Komisioni nxjerr këtë:

P e r f u n d i m

Miratohen dispozitat e Projektligjit për statusin civil dhe raporti i Komisionit funksional – të Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media me amendamente duke konstatuar se nuk përmbajnë implikime buxhetore, prandaj i propozon Kuvendit që në procedurë të mëtejme të miratohet.

Kryetari e hapi shqyrtimin lidhur me pikën e 10-të të rendit të ditës:

10. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 2004/46 për regjistrin e statusit civil dhe raportit të Komisionit funksional – Komisionit të Shërbimeve Publike, Administratës Lokale dhe të Mediave me amendamente.

Duke pasur parasysh se nuk kishte vërejtje për këtë projektligj as për raportin e Komisionit funksional me amendamentet e propozuara, Komisioni nxjerr këtë:

P e r f u n d i m

Miratohen dispozitat e Projektligjit për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 2004/46 për regjistrin e statusit civil dhe raporti i Komisionit funksional – Komisionit të Shërbimeve Publike, Administratës Lokale dhe të Mediave me amendamente, duke konstatuar se nuk përmban implikime buxhetore, prandaj i propozon Kuvendit ta miratojë në procedurë të mëtejme.

Kryetari hapi shqyrtimin për pikën e 11-të të rendit të ditës:

Të ndryshme

Kryetari e hapi shqyrtimin lidhur me pikat 11.1 dhe 11.2

11.1

Shqyrtimi i kërkesës së Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë për transferimin e mjeteve të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë, Zhvillimit Rural (MBPZHR) në shumë prej 300,000 € për kategorinë e investimeve kapitale në kategorinë e subvencioneve.

11.2

Shqyrtimi i kërkesës së Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë për transferimin e mjeteve të Ministrisë së Energjisë dhe të Minierave (MEM) në shumë prej 1,000,000 € nga kategoria e investimeve kapitale, në Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit në kategorinë e investimeve kapitale (AKM) për programin e transmisionit KOST.

Kryetari: Duke u bazuar në nenin 27.3 të Ligjit për menaxhimin dhe në përgjegjësitë e financave publike, për transferimin 100% të mjeteve nga një organizatë buxhetore në tjetrën, është e domosdoshme të merret pëlqimi nga Kuvendi dhe PSSP.

Në përputhje me këtë mendoj se është e nevojshme që Komisioni t'i rekomandojë Kuvendit të marrë vendimin mbi transferimin e mjeteve për implementimin e tyre.

Anëtarët tjerë të Komisionit u pajtuan me këtë propozim, prandaj Komisioni nxjerr këtë

P ë r f u n d i m

I rekomandohet Kuvendit t'i miratojë kërkesat e theksuara për transferim të mjeteve për implementimin e tyre.

Kryetari hapi shqyrtimin për pikën ...

11.3

Shqyrtimi i kërkesës së GP-LDD për zbatimin e vendimit të Kryesisë së Kuvendit për ndarjen e mjeteve financiare partive politike dhe të grupeve parlamentare të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës.

Kryetari: Mendoj se kjo kërkesë nuk është çështje e Komisionit dhe për këtë Komisioni nuk mund të vendosë. Kjo është çështje e partive politike, e jo e Kuvendit dhe për këtë ekskluzivisht duhet bërë shqyrtime me partitë politike. Për këtë arsye nuk duhet të mbështetet kjo kërkesë në Komision, për të njëjtën duhet dërguar për shqyrtim partive politike të përfaqësuara në Kuvend.

Besa Gaxherri nuk pajtohem me kryetarin përkitazi me këtë çështje, meqenëse ky buxhet është sistemuar dhe ndarë nga BKK për të gjitha partitë politike. Për këtë arsye Komisioni duhet në mënyrë profesionale t'i japë mbështetje, kurse Kuvendi natyrisht duhet të vendosë për këtë. Realisht këtë kërkesë duhet mbështetur sepse këto mjete i takojnë GP të LDD-së.

Pas konsultimeve të shkurtra Komisioni nxjerr këtë

P ë r f u n d i m

Kërkesa e GP – LDD u dërgohet për shqyrtim partive politike.

Për pikën e 11.4.

Informacioni për propozimin e Komisionit për Kryesinë e Kuvendit me rekomandim për bartjen e mjeteve buxhetore në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë (ZRE), për vitin 2007 nga data 31.07.2007.

Kryetari ka informuar Komisionin me sa vijon: këtu bëhet fjalë për bartjen e mjeteve të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, do të thotë sipas rekomandimit të Komisionit, e në bazë të kërkesës së ZRE për rishqyrtimin e buxhetit për vitin 2007.

Do të thotë, Komisioni nuk ka nxjerrë vendim lidhur me këtë, por vetëm i ka rekomanduar Kryesisë së Kuvendit të miratojë bartjen e shumës prej 45,000.00 € nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve si nënkategori “shërbimet dhe këshillimet e ndryshme intelektuale” në kategorinë e pagave nga të hyrat të cilat realizohen, në përputhje me Ligjin në fuqi nr. 2004/9 për rregullatorin e energjisë, sipas të cilit buxhetin e ZRE e miraton Kuvendi i Kosovës në kuadër të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës.

Mbledhja ka përfunduar në orën 14,05.

Shërbimi i komisioneve

Kryetari i Komisionit,
Naser Osmani